

Nr.Prot. 702

Nr.Prot. 2

MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

NDËRMJET

UNIVERSITETIT “BARLETI” DHE QENDRES “JONATHAN”

PËR

REALIZIMIN E VEPRIMTARISË SË FORMIMIT PROFESIONAL DHE FUSHËN

AKADEMIKE

Preambul: 1. Universiteti “Barleti” (UniBa), i përfaqësuar nga Rektori i këtij institucioni, Prof. Dr. Suzana Guxholli është një institucion i arsimit të lartë jo publik, i cili ndër vite ka promovuar një nivel të lartë edukimi, duke synuar të zhvillojë prirjet e çdo studenti, me objektivin e krijimit të ekspertëve më të mirë, të aftë për të konkuruar në tregun ndërkombëtar. Misioni i Universitetit është krijimi i një institucioni akademik elitare, bazuar në praktikën dhe vlerat më të mira ndërkombëtare, me programe shumëdisiplinore të vënë në jetë nga akademikët më të mirë shqiptarë.

Universiteti “Barleti” e konsideron edukimin shëndetsor si një të mirë dhe përgjegjësi publike që ka për mision:

- të krijojë, të zhvillojë, të përcjellë dhe të mbrojë dijet përmes mësimdhënies, kërkimit shkencor dhe praktikave klinike cilesore;
- të formojë specialistë të lartë dhe të përgatisë shkencëtarë të rinj, në përputhje me prioritetet e zhvillimit të vendit, duke kontribuar në rritjen e standardeve të demokracisë në vend;
- të ofrojë mundësi të barabarta për të përfituar nga edukimi shëndetsor dhe të mësuarit gjatë të gjithë jetës;
- të kontribuojë në zhvillimin ekonomik, social-kulturor dhe shëndetsor në nivel kombëtar dhe rajonal;
- të integrojë mësimdhënien me kërkimin shkencor;
- të nxisë bashkëpunimin ndërkombëtar në fushën e edukimit shëndetsor
- të kontribuojë që kujdesi shëndetësor të përmiresohet dhe sigurohet nga një sistem i integruar i shërbimeve shëndetësore dhe një rrjet institucionesh publike ose private të edukimit shëndetsor;

Dhe



2. Qendra Jonathan, organizatë jofitimprurëse, rregjistruar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqesor, Tiranë me vendimin nr. 683, datë 17.06.2011, me seli në Linz, Tirane, e përfaqësuar nga Oreada Kita, Drejtore Ekzekutive.

Duke vlerësuar rëndësinë e përmirësimit të sistemit arsimor në kuadër të modernizimit të tij;

Duke marrë në konsiderate politikat e ndjekura dhe masat e ndërmarra për funksionimin dhe përmirësimin e një sistemi arsimor profesional të përgjegjshëm dhe modern për t'iu përshtatur kushteve të zhvillimeve sociale, për përmirësimin shërbimit mjekësor dhe social;

Duke inkurajuar angazhimin institucional për të siguruar standarte të larta në veprimtarinë dhe etikën e të gjitha hallkave të sistemit arsimor;

Duke konsideruar se një ndër objektivat kyçe në ushtrimin e veprimtarisë së sistemit arsimor është efikasiteti dhe efënca e administratës arsimore të këtij Universiteti në përputhje me standardet dhe praktikat me të mira vendase dhe ato perëndimore;

Duke afirmuar vullnetin dhe vendosshmërinë për të bashkëpunuar dhe kontribuar në realizimin e qëllimit të kësaj marrëveshjeje për të përmbushur edhe angazhimet në kuadër të Integritimit Evropian të sistemit arsimor në fushën e shërbimit social;

Duke u mbështetur në kuadrin ligjor që rregullon veprimtarinë institucionale, konkretisht, në Ligjin nr. 80/2015, datë 22.07.2015, "*Për Arsimin e Lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë*" dhe në Ligjin nr. Nr.10/107, datë 30.03.2009 "*Për kujdesin Shëndetësor në Republikën e Shqipërisë*";

Palët janë dakortësuar që për të realizuar qëllimin e përbashkët do të respektojnë dispozitat e kësaj marrëveshjeje të shprehura më poshtë.

Neni 1 Objekti dhe Qëllimi i Bashkëpunimit

Qëllimi i kësaj marrëveshjeje është krijimi i bashkëpunimit në fushën akademike si dhe për të kontribuar në procesin e formimit profesional të studentëve praktikantë në realizimin e praktikave të vitit akademik.

Bashkëpunimi institucional ndërmjet Universitetit "*Barleti*" dhe Qendrës Jonathan:

- Vazhdimi i bashkëpunimit dy-palësh ndërinstitucional, midis Universitetit "*Barleti*" dhe "*Qendrës JONATHAN*", të angazhuar për bashkëpunim prej vitit 2018, me marrëveshjen e parë që është nënshkruar mes paleve (22.01.2018).
- Bashkëpunimi në projekte të përbashkëta dhe realizimi i praktikave mësimore dhe atyre profesionale të studentëve të Universitetit "*Barleti*", pranë "*Qendrës JONATHAN*".



Neni 2 Të drejtat dhe detyrimet e palëve

Universiteti “Barleti” angazhohet për:

- Prezantimin paraprakisht të numrin të studentëve dhe listën e plotë të tyre që do të kryejnë praktikatat klinike profesionale, pranë “Qendrës JONATHAN”.
- Paraqitjen e kalendarit dhe programit të praktikës së miratuar në fillim të semestrit, që do të zhvillojnë studentët dhe ndjekjen e zbatimit të saj nga një përfaqësues i ngarkuar dhe i miratuar.
- Respektimin e rregullave të parashikuara në rregulloren e brendshme, si dhe legjislacionin në fuqi me anë të të cilit bëhet rregullimi i funksioneve të brendshme shëndetësore, përfshi respektimin e orareve të përcaktuara.
- Nxitjen, mbështetjen dhe realizimin e projekteve të përbashkëta;
- Shkëmbimin e ambjenteve të përbashkëta për orë laboratorike dhe ose praktika profesionale, zyra e mjedise të tjera në varësi të nevojave dhe mundësive të dy institucioneve.
- Nxitjen, mbështetjen dhe realizimin e veprimtarive të tjera shkencore (konferenca, seminare e botime në fusha me interes të dyanshëm).

Qendra Jonathan angazhohet për:

- Mundësinë e zhvillimit të praktikave në këtë institucion duke firmosur marrëveshjen e bashkëpunimit.
- Caktimin e një mbikqyrësi të studentëve (brenda ngarkesës së punës së përditshme në institucion).
- Dhënien e mendimeve për vlerësimin e punës dhe sjelljen e studentit gjatë periudhës së praktikës pranë organizatës.
- Vënien në dispozicion të studentëve material dhe mjete ndihmëse të nevojshme për formimin e tyre.
- Angazhimin e studentëve praktikantë sipas nevojave që i paraqiten institucionit.

Fakulteti dhe Qendra Jonathan marrin përsipër të bashkëpunojnë për:

- Realizimin e projekteve të përbashkëta në fushën e të drejtave të njeriut, shtetit të së drejtës dhe drejtësisë.
- Përzgjedhjen e studentëve që do të kryejnë praktikën mësimore.
- Shkëmbimin rregullisht të informacioneve në lidhje me ecurinë e praktikës mësimore.



- Shkëmbimin e informacioneve në lidhje me veprimtarinë e secilës palë, për çështje që paraqesin interes për aktivitetin institucional të palës tjetër.

Neni 3

Komunikimi mes palëve

Palët angazhohen të mbajnë një komunikim të vazhdueshëm ndërmjet tyre dhe të shkëmbejnë çdo informacion të nevojshëm për përmbushjen e detyrave të tyre.

Secila pre palëve do të caktojë një person kontakti, përgjegjës për të bashkërenduar aktivitetet e marrëveshjes, me qëllim që komunikimi dhe shkëmbimi i informacionit të jetë i shpejtë, konkret dhe i efektshëm. Personi përkatës i komunikohet palëve respektive të kësaj marrëveshje brenda javës së parë mbas firmosjes së saj.

Neni 4

Ndryshimi i Marrëveshjes

Kjo marrëveshje mund të ndryshojë vetëm me marrëveshje të palëve ndërmjet shkëmbimit të komunikimit me shkrim .

Neni 5

Kushtet shtesë

Kur është e nevojshme, terma të mëtejshëm do t'i shtohen këtij Protokolli; këto do të sigurojnë zhvillimin e mëtejshëm të programit dhe planifikimin e specifikave aktivitetet dhe do të përcaktojnë detyrimet e të dy institucioneve pjesëmarrëse në zhvillime të tilla të mëtejshme.

Neni 6

Vlefshmëria e marrëveshjes

Marrëveshja do të bëhet aktive në ditën e nënshkrimit dhe do të funksionojë për 3(tre) vjet nga ajo datë, dhe do të rinovohet automatikisht për periudha të tjera prej 3 (tre) vjetësh nëse nuk anulohet nga asnjëri nga partnerët.

b. Nëse secili nga partnerët dëshiron të anulojë Marrëveshjen , ata duhet të njoftojnë 6 (gjashtë) muaj përpara afatit dhe akti i anulimit do të jetë pa paragjykim ndaj veprimeve dhe aktiviteteve ekzistuese dhe në vazhdim.

c. Dispozitat e këtij Marrëveshjeje mund të ndryshohen në çdo kohë me pëlqimin e ndërsjellë me shkrim të të dy institucioneve.



Neni 7

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Çdo mosmarrëveshje lidhur me interpretimin ose zbatimin e kësaj marrëveshjeje zgjidhet me mirëkuptim mes palëve.

Neni 8

Dispozita të fundit


Marrëveshja hyn në fuqi ditën e nënshkrimit të tij dhe pregatitet e nënshkruhet në 4 (katër) kopje origjinale, dy prej të cilave depozitohen në **Universitetin Barleti (UniBa)** dhe dy në **Qendrën Jonathan**.

Nënshkruar në Tiranë, në 27.06 2023.

REKTORI

I UNIVERSITETIT "BARLETI"

PROF. DR. SUZANA GUXHOLLI



DREJTORE EKZEKUTIVE

QENDRA "JONATHAN"

ZNJ. OREADA KITA

P/Sanije Çoku

